

# Statut i nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar

## Kreu I

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.**

### Neni 1:

#### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesi**

(1) Sot, me ( 10.08.2022 ), ne, themeluesit , kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **PANELE DIELORE FOTOVOLTAIKE**

(2) Themeluesit e shoqerise jane ( mbiemrat, emrat ose forma dhe emeri ligjor i shoqerise, adresa ose selia e numri dhe vendi i regjistrimit ):

- Gazmir Albrahimi.

Rruga Misto Mame nr. 5, Lagjia Skender Libohova Lushnje

- Albert Vrapit : Kodra e Diellit Tirane.

### Neni 2 :

#### **Objekti :**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem:

Tregtim me shumice dhe pakice, impianteve/paneleve fotovoltaike. Ofrimi i konsulences dhe asistences teknike per projektimin, studimin, mirembajtjen, mbikqyrje, kolaudim, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, dhe te cdo materiali tjeter ndihmes te sistemit dhe rrjetit elektrik. import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme elektrike, elektroshtepiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike, te ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme per mire menaxhimin e energjise, sisteme ndricimi, te telekomunikacionit si dhe impianteve te tjera te ngjashme te destinuara per objekte civile dhe industriale .Shitja me shumice dhe pakice brenda vendit te materialeve te ndryshme elektrike dhe pajisjeve te tyre te gjitha llojeve te materialeve te tjera industriale, si impiante ndricimi, impiante te energjise alternative. Konsulenc dhe cdo aktivitet qe lidhet me fushen e energjise. Import eksport mallra e pajisje te teknologjise ne fushen energjitikes etj, qe do te perdoren ne ndertimin, mirembajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impjante fotovoltaike e forma te tjera te prodhimit te energjise nga burime te rinovueshme. Tregti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshme industriale, bujqesore, materiale ndertimi, pajisje elektronike, hidraulike, dhe elektrike, Tregtim te materialeve elektrike dhe paisjeve laboratorike, transformatore dhe elektromotorra. Tregtim

import eksport me shumice dhe pakice te materialeve dhe paisjeve elektrike, industriale e elektro-shtepiake, paisjeve e sistemeve te impianteve te ftohjes, ngrohjes, kondicionere si dhe impianteve te tjera te ndryshme te cfardolloji. Projektim dhe instalim i paisjeve elektrike, industriale, elektro-shtepiake, sistemeve te ftohjes- ngrohjes, kondicionere, sherbime mirmbajtje dhe servisi te ndryshme per materialet e paisjet elektike dhe industriale. Ndertim dhe rikonstruksion vepra hidroteknike si hidrovore, ujesjellsa kanalizime etj.. Ndertim dhe rikonstruksion diga te ndryshme, prita lumenjsh, prenjsh etj.. Paisje digash me sensoret e nevojshem per monitorim te ndryshme. Instalimet e te gjitha llojeve te paisjeve per diga dhe vepra te tjera industriale si : HEC, impiante pastrimi, dekantimi etj.. Ndertim dhe rikonstruksion ujesjellesa te ndryshem. Shtirije tubacionesh per uje te pijshem, industri etj. Ndertim depo te ndryshme per uje, karburante etj. Ndertim, asfaltim dhe rehabilitim rruges te ndryshme. Ndertim dhe rikonstruktim kanalizimesh te ndryshem Ne fushen elektrike : Ndertim, furnizim, rikonstruksion i te gjitha fushave elektrike si : Linja elektrike te te gjitha llojeve, Tension i ulet, TM, TL, Ndertim dhe rikonstruksione ne stacione te ndryshme TM, TL. Ndertim dhe rikonstruksion kabinash te ndryshme TU, TM, TL. Furnizim dhe instalime paisjesh nga HEC-e dhe vepra te tjera industriale si : Turbina, lopatapune, transformatore, vinxha, nyje lidhese te ndryshme etj. Impiante ngrohesh dhe ftohes ne vepra te ndryshme industriale. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

### **Neni 3:**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e papercaktuar :

### **Neni 4:**

#### **Selia.**

- (1) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen : Rruga Misto Mame nr. 5, Lagjia Skender Libohova Lushnje
- (2) Adresa e faqes se internetit te shoqerise:
- (3) Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronike eshte si vijon:  
gaz.alb@hotmail.com

## **Kreu II**

### **Kapitali**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

( 1) Kapitali themeltar fillestar I shoqerise eshte 100 000 leke ( \* sipas ligjit kapitali nuk mund te jete me I vogel se 100 leke\*). Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues Gazmir Albrahimi , Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50000 leke, qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

2. Ortaku themelues Albert Vrapit, Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 50000 leke, qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakeve eshte paguar ne para

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### **Neni 7 :**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise.
- b) Shitblerjes.
- c) Trashegimise.
- d) Dhurimit.
- e) Cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8.**



### **Organi Vendmarres:**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuar ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.

b) ndryshimin e statutit.

c) emerimin e shkarkimin e administratoreve.

ç) emerimi dhe shkarkimi I likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.

d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “ c “ dhe “ ç “ te kesaj pike.

dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.

f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimin e tjera ndaj administrates.

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

h) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortake tjetet apo nga nje person i trete.

Admintratori mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshine edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nese parashikohet nga statute, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marr vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, per te marr vendime, pavaresisht parregullsise.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marr vendime te vlefshme vetem , nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votive, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjet elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me larte, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejten rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve.**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) **Percaktimi I politikave tregtare te shoqerise.**
- b) **Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.**
- c) **Emerimin e shkarkimin i likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar.**
- d) **Percaktimin e shperblimeve.**
- e) **Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administartoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.**
- f) **Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.**
- g) **Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.**

Cdo ndryshim statiti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 12**

#### **Perjashtimi nga e drejta e votes.**

1. Ortaku mund te ushtroje te drejtene e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
  - a) **Vleresimin e veprimtarise se tij.**
  - b) **Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.**
  - c) **Ngritjene e nje padie ndaj tij nga shoqeria.**

- d) **Dhënie ose jo të përfitimeve të reja.**
2. Kur ortakët përfaqësohen nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt të interesit, ashtu si dhe ortakët, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13**

#### **Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 270 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë dispozitë është i pavlefshëm.
3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Te dhënat e identifikimit:**

##### **( emri mbiemri):**

- Gazmir Albrahimi

### **Neni 14**

#### **Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare.
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë.
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetorë, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet e fitimeve, i paraqisin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe egzistencën e shoqërisë.
- f) Kryejnë regjistrime dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit.
- g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblesën e Përgjithshme, në rastet kur:



- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermejtme financiare, rezulton ose egziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te mardhenieve kontraktore te shoqerise, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15**

### **Pergjegjesite e Administratorit.**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo pe faje te kryera gjate adminstrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamerituara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17, 18 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerie Tregtare”, administrator detyrohet.

1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
  - b) te ushtroje kompetencat qe i njeh ligji dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
  - c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim.
  - d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundshem, te interesave personale me ate te shoqerise.
  - dh) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesjen e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregatare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
3. Nese administrator vepron ne kundershtrim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje

- shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloj cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperblej shoqerise demte e shkatuara, ne kundershtim me dispozitat e ligjit “ Per Tregtaret e Shoqerit Tregtare”, kryen veprimet e meposhtme.
- a) U kthen ortakeve kontributet.
  - b) U paguan ortakeve interesat apo dividente.
  - c) U shperndan aktive shoqerise.
  - d) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare duhet te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
  - e) Jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimet financiare, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet ekryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## **Kreu IV**

### **Viti financiar- ekspertet.**

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar.**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertet.**

Eksperti ka per te detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithhevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruar prej tij per ratet kur ai eshte i ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit vjetor si dhe ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat



eshte i detyruara t'ja paraqes e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## **Kreu**

### **Prishja – riorganizimi i shoqerise**

#### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi.**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj.
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit.
- d) Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhjen me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723,date 03.05.2007, “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.
- e) Me vendim te Gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojn menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje ose disa likuidator dhe shenuar ne cdo document te nxjerr prej tij emrin e likidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeria ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqerise tregtare ka si pasoje hapjene procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, Brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person I interesuar mund t'I drejtohet gjykates, per te percaktuar nje likuidues.

#### **Neni 19**

##### **Riorganizimi I shoqerise bashkimi-ndarja.**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asambles se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te ligjit 9901, date 14.04.2012, “ Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare”.

#### **Neni 20**

##### **Baza ligjore.**

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohet dispozitat e ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerit Tregtare”, Kodit Civil dhe cfardo ligji tjeter specific ne Republiken e Shqiperise.

## **Neni 21**

### **Mosmarrveshjet.**

Per mosvarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo intepretimimin e ketij statiti, si dhe per cdo mosmarrveshje qe mund te lind midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetent Gjykata Shqiptare.

## **O R T A K E T**

### **E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR PANELE DIELLORE FOTOVOLTAIKE**

**GAZMIR ALBRAHIMI**



**ALBERT VRAPI**

